



ALBANIAN CENTER FOR  
QUALITY JOURNALISM

# RAPORT I NDËRMJETËM



**SPAK**  
NE SYTE E MEDIAS



K  
O  
R  
R  
I  
K

2  
0  
2  
1

## MBI MONITORIMIN E RAPORTIMIT MEDIATIK TË VEPRIMTARISË SË SPAK DHE BKH

PERIUDHA PRILL - KORRIK 2021



FONDACIONI SHOQËRIA  
E HAPUR PËR SHQIPËRINË

Mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë. Mendimet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e donatorit.

# OBJEKTIVAT DHE METODOLOGJIA

Monitorimi është kryer në pesë televizione që shikohen në Republikën e Shqipërisë, përkatësisht Tv Top Channel, Tv Klan, TVSH, Tv Neës 24 dhe A2 CNN, që përfaqësojnë tipologji të ndryshme

- a- Sa i përket përcjelljes së informacionit; tre janë televizione gjeneralistë dhe dy janë televizione informative (pra përcjellin informacion 24/7).
- b- Sa i përket shtrirjes gjeografikë të mbulimit me sinjal të territorit të Republikës së Shqipërisë.
- c- Sa i përket pronësisë, katër janë private dhe njëri është publik.

Monitorohen vetëm edicionet qendrore të lajmeve. Edicionet e tjera janë përsëritje (me fare pak freskime) të lajmeve që transmetohen në këtë edicion.

Një rrethanë tjetër që na orientoj drejt monitorimit vetëm të edicionit qendror ishte edhe natyra e dy televizioneve informative 24/7. Këto të fundit transmetojnë lajme gjatë gjithë kohës dhe në dy formate të ndryshme; edhe me kronika, edhe me titra.

**Në hartimin e metodologjisë së dorëzuar para fillimit të monitorimit është synuar të arrihen këto rezultate!**

- a- Të krijohet një bazë të dhënash për numrin dhe një listë e titujve të lajmeve që raportohen mbi veprimtarinë e SPAK dhe BKH
  - b- Të shikohet se cili është raporti (në kohë) mes lajmeve mbi veprimtarinë e SPAK dhe BKH dhe gjithë lajmeve të tjera në edicionet qendrore të lajmeve.
  - c- Të monitorohet rëndësia që redaksia e informacionit i kushton lajmeve mbi veprimtarinë e SPAK dhe BKH, pra çfarë vendi kanë këto lajme në axhendën e secilës prej redaksive të monitoruara.
  - d- Të verifikohet se cili është burimi i informacioni mbi këto struktura. Nëse burimi është zyrtar apo informacioneve mbi SPAK dhe BKH gazetarët u qasen nëpërmjet rrugëve të tërthorta siç janë subjektet e hetuara apo ata që vuajnë pasojat e këtyre hetimeve. Nëse informacioni transmetohet bazuar nga pikëvështrimi institucional apo human.
  - e- Të shikohet nëse televizionet në pasqyrimin e lajmeve mbi veprimtarinë e SPAK dhe BKH kanë të njëjtin qëndrim që kanë edhe ndaj strukturave të tjera të qeverisë, apo ky qëndrim ecën në drejtim të kundërt me qëndrimin që mbajnë ndaj veprimtarisë së qeverisë.
- Qëllimi i imonitorimit është të vëzhgojë veprimtarinë e SPAK dhe BKH, por jo duke analizuar statistikisht dhe duke analizuar punën e saj konkrete (studim nisur nga brenda objektit), por duke e parë këtë veprimtari duke u nisur nga lajmet që raportojnë mbi aktivitetin e saj (studim, duke e vëzhguar objektin nga jashtë tij)

# GJETJET E PËRGJITHSHME

NGA MONITORIMI I LAJMEVE QË JANË RAPORTUAR MBI DY STRUKTURAT SHUMË TË RËNDËSISHME QË JANË NGRITUR PËR TË LUFTUAR KRIMIN E ORGANIZUAR DHE KORRUSPIONIN NË NIVELET E LARTA, VIHEN RE KËTO PËRFUNDIME. NË KËTË RAPORT NUK JANË PËRSËRITUR GJETJET E EVIDENTUARA NË RAPORTIN E PARË.

-VIHET RE NJË SHTIM I RAPORTIMIT TË LAJMEVE QË KANË TË BËJNË ME VEPRIMTARINË E STRUKTURAVE TË SPAK DHE BKH. SIDOMOS PËRGJATË GJYSMËS SË PARË TË MUAJIT KORRIK, KA PASUR ÇDO DITË, E NË DISA PREJ DITËVE MË SHUMË SE NJË LAJM. DUKE SHKUAR DERI NË KATËR LAJME NË DITË. LAJMET E RAPORTUAR KISHIN SI BAZË BURIMET ZYRTARE TË KËTYRE DY STRUKTURAVE. PRA, LAJMET ISHIN NGA SPAK DHE BKH PËR SPAK DHE BKH, QË NË KËTË STUDIM DO TË QUAJMË INFORMACION ME KARAKTER AUTO-INFORMUES. NË KËTË LOGJIKË, INFORMACIONI LËVIZ ME DREJTIMIN NGA BRENDA JASHTË. KY INTENSIFIKIM I LAJMEVE MBI VEPRIMTARINË E SPAK E BKH KA RRITUR PRITSHMËRINË E AUDIENCËS NDAJ TYRE. KJO DUKET QARTË NË KOMENTET E ATYRE QË KONSIDEROHEN SI LIDERA TË OPINIONIT PUBLIC, POR EDHE NË RRJETET SOCIALE.

- NDËRKOHË QË PËR MUAJIN PRILL, LAJMET QË PËRFSHININ SPAK DHE BKH KISHIN NJË NATYRË TJETËR INFORMACIONI. LAJMI KISHTE DREJTIMIN, NGA JASHTË BRENDA. PRA, ISHIN STRUKTURAT E TJERA, SIDOMOS PARTITË POLITIKE QË DONIN TË BËNIN LAJM, DUKE TENTUAR QË TË PËRFSHININ NË LUFTËN E TYRE POLITIKE EDHE SPAK-BKH. SIÇ EDHE ËSHTË RAPORTUAR PUBLIKISHT DHJETRA DENONCIME JANË BËRË PËRGJATË FUSHATËS ELEKTORALE PËR ZGJEDHJET PËRLAMENTARE TË 25 PRILLIT.

- PËR LAJMET E RAPORTUARA NË PIKËN 2, TË KËTIJ RAPORTI MUNGOJNË RAPORTIMET MBI ECURINË E KËTYRE DENONCIMEVE. KJO LIDHET EDHE ME NATYRËN E MEDIAS, "SINDROMA E HARRESËS". NDËRKOHË QË NGA ANA E SPAK DHE BKH NUK KA ASNJË REAGIM, QOFTË EDHE RAPORTUES OSE INFORMUES PËR TË INFORMUAR PUBLIKUN, NËSE "DENONCIMET" JANË DEPOZITUAR ZYRTARISHT NË KËTO INSTITUCIONE DHE CILI ËSHTË QËNDRIMI NDAJ TYRE.

# GJETJET E VEÇANTA

- THUAJSE TË GJITHA TELEVISIONET E MONITORUARA RAPORTOJNË LAJME MBI VEPRIMTARINË E SPAK, BKH MADJE EDHE TË GJYKATËS SË POSAÇME, E CILA JEP VENDIMIN NDAJ HETIMET QË KA KRYER SPAK DHE BKH.
- LAJMET PROPORCIONALISHT KANË TË NJËJTËN GJATËSI KOHORE DHE AFËRSISHT TË NJËJTIN POZICION NË EDICIONET QËNDRORE TË TELEVISIONEVE.
- NGA TEMATIKA, FORMA E RAPORTIMIT, MËNYRA E ORGANIZIMIT TË KRONIKAVE KONSTATOHEN EDHE NUANCAT E QËNDRIMIT QË NJË TELEVISION I ÇAKTUAR MBAN NDAJ KËTYRE DY STRUKTURAVE, POR EDHE NDAJ POLITIKËS NË PËRGJITHËSI. TELEVISIONI TOP CHANNEL NUK KA RAPORTUAR LAJME MBI DENONCIMET QË PARTIA DEMOKRATIKE KA KRYER NDAJ STRUKTURAVE SHETËRORE OSE ATYRE TË MAZHORANCËS QEVERISËSE. DHE E KUNDËRTA TV KLAN, NUK KA RAPORTUAR MBI DISA DENONCIME QË MAZHORANCA I KA BËRË NË SPAK PËR PËRFAQËSUES TË PARTISË DEMOKRATIKE. NDËRSA TVSH NUK RAPORTON ASNJËRËN E AS TJETRËN.

# ILUSTRIME

NË 21 PRILL SËRISH TOP CHANNEL PUBLIKON LAJMIN ME TITULL "KAPET TURKU, BLINTE VOTA PËR LSI-NË", E NË LAJM THUHET SE KËTË DOSJE PO E HETON SPAK SE ËSHTË KRIM ZGJEDHOR.

PO NË DATËN 23 DHE 24, KA LAJME PËR HETIMET E SPAK PËR BLERJE TË VOTAVE. POR, NË TË DYJA KËTO DITË, LAJMET TREGOJNË SE HETIMET JANË VETËM PËR OPOZITËN. MADJE NË DATËN 24 NJË DITË PARA ZGJEDHJEVE, INFORMOHET SE SPAK KA SHPALLUR NË KËRKIM NJË KANDIDAT PËR DEPUTET TË LSI-SË, QË ËSHTË RREGJISTRUAR DUKE BLERË VOTA.

NË DATËN 25 DHE 26 KA QENË MARATONË INFORMATIVE PËR ECURINË E PROCESIT TË VOTIMIT DHE NUMËRIMIT DHE NUK KA PASUR EDICION TË ZAKONSHËM LAJMESH.

NË DATËN 29 PRILL ËSHTË LAJMI "KANDIDATI I LSI-SË ENDE NË KËRKIM", NJË KRONIKË KU KRITIKOHEJ POLICIA E TIRANËS E CILA EDHE PAS 6 DITËSH ENDE NUK KISHTE KAPUR KANDIDATIN PËR DEPUTET TË LSI-SË. NË LAJM, PËRMENDET VETËM NJË FJALI QË HETIMET PËR KËTË RAST PO KRYHEN NGA SPAK. INTERESANT ËSHTË FAKTI QË LAJMIN PËR SPAK E KISHTE BËRË GAZETARI QË MBULON LAJMET POLITIKE TË MAZHORANCËS, MUHAMED VELIU. FUNDI I STAND-UP-IT TË MUHAMED VELIUT ISHTE NJË INFORMACION SFONDI, SIPAS TË CILIT PËR TRAGJEDINË E GËRDECIT ËSHTË PËRFOLUR EDHE DJALI I ISH-KRYEMINISTRIT SALI BERISHA, SHKËLZEN BERISHA.

NDËRKOHË, TITULLI I INTERVISTËS SË ZAMIRA DURDËS ISHTE: PËRGJEGJËS ËSHTË EDHE BERISHA". PRA, LAJMI ISHTE ORJENTUAR POLITIKISHT. KËTË LAJM E KISHTE EDHE TELEVISIONI PUBLIK SHQIPTAR SI DHE NEËS 24. NDËRSA TELEVISIONI KLAN DHE A 2 CNN NUK E KISHIN SI LAJM.

NË DATËN 7 MAJ, TOP CHANNEL PUBLIKON DY KRONIKA, QË JANË NË FORMËN E ANALIZËS. PA AUTOR. NË TOTAL TË DYJA RRETH 5 MINUTA. NJËRA LIDHET ME MËNYRËN SE SI KA SHPËTUAR FATMIR MEDIU PA U DËNUAR PËR GËRDECIN. TJETRA LIDHET ME NJË HETIM TË FILLUAR NGA SPAK, SIPAS KRONIKËS, PËR DJALIN E ISH-KRYEMINISTRIT BERISHA.

NDËRKOHË, TELEVISIONI KLAN, KA KRONIKËN PËR DËNIMIN QË KA KËRKUAR PROKURORIA NDAJ ISH-PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM ADRIATIK LLALLA

NË DATËN 16 MAJ, KRONIKA E BËRË PËR GJYKATËSIT QË JANË RRËZUAR NGA VETINGU DHE PO NDIQEN NGA SPAK, ËSHTË REALIZUAR NGA REPORTERI I SEKTORIT POLITIK MUHAMED VELIU. LAJMI NUK KA BURIME TË QARTA.

# PËRFUNDIME

- VIHET RE SE TELEVISIONI TOP CHANNEL PUBLIKON EDHE LAJME TEMATIKE QË JANË TË IDEUARA DHE TË REALIZUARA NGA GAZETARJA ANILA HOXHA. KJO PRAKTIKË NUK HASET TEK TELEVISIONET E TJERA.
- NDËRKOHË NË DISA RASTE, EDHE PSE NË TEKST PËRMENDET AKTIVITETI I SPAK DHE BKH AKRONIMI I KËSAJ STRUKTURE NUK PËRMENDET NË TITULL. EDHE PSE KA NEVOJË PËR INTERVISTA ME DREJTUESIT E KËTYRE REDAKSIVE, KAM DYSHIMIN SE KJO PRAKTIKË TREGON EDHE NJË LLOJ QËNDRIMI QË REDAKSIA PËRKATËSE MBAN NDAJ KËTYRE STRUKTURAVE SHUMË TË RËNDËSISHME.
- GJATË MONITORIMIT ËSHTË VËNË RE SE NË LAJME KA EDHE ZËRA TË TJERË QË FLASIN, EKSPERTË, ZYRTARË, "VIKTIMA" TË LAJMIT, JO VETËM GAZETARËT. KJO E BËN MË TË BESUESHËM DHE ME RITËM INFORMACIONIN QË KONSUMOJNË QYTETARËT.
- TEK TUK VIHEN RE LAJME QË NUK PËRMBAJNË BURIME ZYRTARE TË SPAK DHE BKH, POR OPEROHET ME LAJME TË SIGURTA. KJO PRAKTIKË E ÇON MEDIAN NË NJË FUSHË TË PASIGURITË, NË TË CILËN BURIMET MUND TË MANIPULOJNË MEDIAN PËR ARSYE TË PAQARTË DERI TEK TË DYSHIMTA.